

CILAT JANË PERCEPTIMET E QYTETARËVE TË KOSOVËS PËR MARRËDHËNIET NDËRETNIKE?

Rezultatet e anketës lidhur me nxitjen e marrëdhënieve dhe pajtimin ndëretnik



Projekti implementohet nga:



Në partneritet me:



Autorë:

Shpat Balaj dhe Gramos Sejdiu

Recensimi i brendshëm:

Dr. Ramadan Ilazi

Koordinatorë të punës në terren:

Florent Gashi, Dea Fetiu, Dorjeta Rukiqi, Milica Radovanović, Gramos Sejdiu, Altin Gashi

Hulumtues në terren:

Rea Bojku, Viola Rexhepi, Melisa Kadolli, Erdita Jaha, Donjeta Bajraktari, Ereza Vladi, Ema Ljačković, Rea Mehana, Flakrina Maloku, Era Vitija, Katarina Denić, Ivan Krstić, Vuk Staletović, Milica Krstić, Laureta Haziri, Orhidea Himaduma, Sanja Vuković, Rada Kostić, Rion Krasniqi, Aleksandra Popović, Vladan Dimitrijević, Jetmira Morina, Venera Maksuti, Nenad Živković.

Disklaimer: © Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta mbrojnë të drejtat dhe pronën intelektuale. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim nga QKSS. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +381 38 221 420.

Të dhënat e paraqitura në raport janë përfutur nga anketa e realizuar në kuadër të projektit Nxitja e bashkëpunimit dhe pajtimit ndëretnik (në tekstin e mëtejshëm FIECR, akronim i emërtimit në gjuhën angleze Fostering Inter-Ethnic Cooperation and Reconciliation), e nisur në tetor-nëntor 2022. FIECR është një projekt i implementuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe Iniciativa e Re Sociale (në tekstin e mëtejshëm NSI, akronim i emërtimit në gjuhën angleze New Social Initiative) me synim nxitjen e bashkëpunimit ndëretnik në Kosovë duke ofruar hapësirë ndërveprimi për ndërtimin e besimit të ndërsjellë, duke krijuar mundësi që qytetarët së bashku të identifikojnë/adresojnë e përbashkët të sfidave të zakonshme dhe të bashkëpunojnë për të gjetur zgjidhje brenda komunitetit. Projekti mbështetet nga Fondi i Paktit të Stabilitetit i Ministrisë së Jashtme Federale Gjermane. Gjetjet tregojnë se si qytetarët i perceptojnë apo informohen për çështjet e paraqitura në këtë raport. Së këndejmi, pikëpamjet e paraqitura në këtë raport nuk përfaqësojnë patjetër pikëpamjet e QKSS, NSI, Zyrës Federale të Jashtme Gjermane apo Ambasadës Gjermane në Kosovë.

Raporti origjinal është i shkruar në gjuhën angleze. Versioni i mëposhtëm është përkthim i versionit origjinal, nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.

Mbeshtetur nga:



CILAT JANË PERCEPTIMET E QYTETARËVE TË KOSOVËS PËR MARRËDHËNIET NDËRETNIKE?

Rezultatet e anketës lidhur me nxitjen e marrëdhënieve dhe pajtimit ndëretnik

PËRMBAJTJA

Tabelat	1
Hyrje.....	3
Cila është pikëpamja e qytetarëve për gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë?	4
Si e perceptojnë qytetarët bashkëpunimin ndëretnik?	13
A janë qytetarët të kënaqur me punën e institucioneve të nivelit komunal dhe qendror në avancimin e marrëdhënieve ndëretnike?	17
Sa e pranojnë njëri-tjetrin qytetarët e Kosovës?.....	21
Konkluzionet kryesore.....	25
Rreth projektit FIECR - Nxitja e bashkëpunimit dhe pajtimit ndëretnik.....	26

TABELAT

Tabela 1	Perceptimet në lidhje me shqetësimet kryesore të komuniteteve (n=1226)	4
Tabela 2	Perceptimet në lidhje me shqetësimet kryesore të komuniteteve sipas përkatësisë etnike	5
Tabela 3	Perceptimet në lidhje me këroënimet kryesore për paqen dhe sigurinë e komuniteteve (n=1226)	5
Tabela 4	Perceptimet në lidhje me këroënimet kryesore për paqen dhe sigurinë e komuniteteve sipas përkatësisë etnike	6
Tabela 5	Perceptimet në lidhje me ndjenjën e sigurisë në shoqërinë kosovare sipas përkatësisë etnike	6
Tabela 6	Perceptimet nëse ka diskriminim ndaj grupeve pakicë në Kosovë. Të përgjithshme dhe sipas përkatësisë etnike	7
Tabela 7	Perceptimet nëse dhuna ndaj grupeve pakicë në Kosovë është ndëshkuar në mënyrë adekuate. Të përgjithshme dhe sipas përkatësisë etnike	7
Tabela 8	Vlerësimi i të anketuarve për gjendjen e përgjithshme të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë. Të përgjithshme dhe sipas përkatësisë etnike	8
Tabela 9	Vlerësimi i të anketuarve për gjendjen e përgjithshme të marrëdhënieve ndëretnike në komunën e tyre. Të përgjithshme dhe sipas përkatësisë etnike	8
Tabela 10	Perceptimet në lidhje me përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë gjatë viteve të fundit. Të përgjithshme dhe sipas përkatësisë etnike	9
Tabela 11	Perceptimet në lidhje me potencialin për përmirësim të mëtejshëm të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë në të ardhmen. Të përgjithshme dhe sipas përkatësisë etnike	9
Tabela 12	Perceptimet në lidhje me shumetnitetin, sipas përkatësisë etnike	10
Tabela 13	Perceptimet nëse sjellja e liderëve politikë dhe gjuha e tyre kanë ndikim në marrëdhëniet ndëretnike. Të përgjithshme dhe sipas përkatësisë etnike	11
Tabela 14	Perceptimet nëse në komunitat e të anketuarve ka liri për të folur hapur për çështjet politike. Të përgjithshme dhe sipas përkatësisë etnike	11

Tabela 15	Vlerësimi i të anketuarve për gjuhën e përdorur nga liderët politikë në Kosovë kur bëhet fjalë për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndëretnik. Të përgjithshme dhe sipas përkatësisë etnike	12
Tabela 16	Perceptimet në lidhje me rëndësinë e bashkëpunimit ndëretnik sipas përkatësisë etnike	13
Tabela 17	Perceptimet për kontributin e marrëdhënieve ndëretnike në zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe integrimin evropian sipas përkatësisë etnike	14
Tabela 18	Vlerësimi i të anketuarve për gjendjen e bashkëpunimit ndëretnik në Kosovë. Të përgjithshme dhe sipas përkatësisë etnike	15
Tabela 19	Perceptimet në lidhje me pengesat më të rëndësishme për marrëdhënie më të mira ndëretnike në Kosovë. Të përgjithshme dhe sipas përkatësisë etnike	15
Tabela 20	Gatishmëria e të anketuarve për të votuar për një parti politike që nuk përfaqëson grupin e tyre etnik. Të përgjithshme dhe sipas përkatësisë etnike	16
Tabela 21	Perceptimet nëse gjuhët e komuniteteve tjera, si shqipja dhe serbishtja, do të duhej të mësohen në shkolla. Të përgjithshme dhe sipas përkatësisë etnike	16
Tabela 22	Perceptimet nëse qytetarët e Kosovës ndihen të përfaqësuar në shoqërinë kosovare. Të përgjithshme dhe sipas përkatësisë etnike	17
Tabela 23	Perceptimet nëse qytetarët e Kosovës ndihen të përfaqësuar në komunat e tyre përkatëse. Të përgjithshme dhe sipas përkatësisë etnike	18
Tabela 24	Perceptimet në lidhje me punën e Qeverisë së Kosovës dhe komunave në avancimin e marrëdhënieve ndëretnike sipas përkatësisë etnike	18
Tabela 25	Perceptimet nëse qytetarët janë të njohur me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi në komunat e tyre përkatëse. Të përgjithshme dhe sipas përkatësisë etnike	19
Tabela 26	Dijenja e të anketuarve për ekzistimin e ligjeve që mbrojnë të drejtat e tyre	20
Tabela 27	Perceptimet nëse shoqëria kosovare është tolerante ndaj etnive të tjera. Të përgjithshme dhe sipas përkatësisë etnike	21
Tabela 28	Gatishmëria e të anketuarve shqiptarë-K për të pranuar komunitetet e ndryshme në një sërë shkallësh, nga marrëdhëniet më të gjera deri tek ato më personale	22
Tabela 29	Gatishmëria e të anketuarve serbë-K për të pranuar komunitetet e ndryshme në një sërë shkallësh, nga marrëdhëniet më të gjera deri tek ato më personale	23

HYRJE


Çështjet politike në vijimësi dhe tensionet e pazgjidhura ndërmjet komuniteteve si rezultat i luftës në Kosovë në vitin 1999 vazhdojnë të paraqesin pengesa për avancimin e marrëdhënieve ndëretnike në vend. Bashkëpunimi ndëretnik në Kosovë, veçanërisht ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës, ende pengohet nga trajtimi joadekuat i krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut. Deri më sot, përpjekjet për të thyer ngërçin në marrëdhëniet ndëretnike janë bërë kryesisht në margjinat e dialogut Kosovë-Serbi, i cili filloi në vitin 2011, duke lënë në hije procesin e mundshëm të pajtimit dhe bashkëpunimit shoqëror. Si rezultat, në vend të një debati shoqëror që përpiket të zbulojë të përbashkëtat dhe të minimizojë pabarazitë, perspektiva e popullatës serbe dhe shqiptare në Kosovë në lidhje me gjendjen e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit të tyre të ndërsjellë ka mbetur disi e mjegullt dhe me prirje ndaj proceseve politike. Prandaj, ky raport synon të pasqyrojë pikëpamjet e këtyre dy komuniteteve për statusin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndëretnik në Kosovë bazuar në gjetjet e anketës së realizuar si pjesë e projektit "FIECR – Nxitja e bashkëpunimit dhe pajtimit ndëretnik", i cili u nis nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dhe Iniciativa e Re Sociale (NSI) nga fundi i tetorit dhe fillimi i nëntorit 2022. Raporti përbëhet nga katër kapituj kryesorë. Kapitulli i parë përmbledh perceptimet e qytetarëve për gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë, ndërsa pasohet nga kapitulli i dytë me fokus në pikëpamjet e qytetarëve për bashkëpunimin ndëretnik. Nga ana tjetër, kapitujt tre dhe katër ofrojnë një përmbledhje të gjetjeve të anketës në lidhje me përfaqësimin e perceptuar të komunitetit shqiptar dhe serb në institucionet e nivelit komunal dhe qendror, si dhe pranimin e grupeve të tjera etnike në komunitetet e tyre përkatëse.

Analiza e këtij raporti bazohet në rezultatet e intervistave ballë për ballë me të anketuar të përzgjedhur rastësisht në nëntë komuna shumetnike në Kosovë. Hulumtimi në terren për nevojat e këtij raporti është kryer nga data 28 tetor 2022 deri më 3 nëntor 2022. Pyetëtori i anketës përbëhej kryesisht nga pyetje të tipit të mbyllur në formë të shkallës Likert me pesë pikë, të pasuara nga disa pyetje të tipit të hapur pa opsione të paracaktuara. Mostra kombëtare për anketën përfshiu 1,226 të anketuar, prej të cilëve 729 ishin shqiptarë të Kosovës dhe 497 serbë të Kosovës. Mostrimi i anketës u bë sipas parimeve të mostrimit të shtresuar. Në këtë drejtim, mostra fillimisht identifikoi nëntë lokalitete shumetnike në Kosovë duke përfshirë Mitrovicën e Jugut, Mitrovicën e Veriut, Shtërpcën, Graçanicën, Novobërdën, Vitinë, Rranillugun, Kamenicën dhe Lipjanin. Faza e dytë e mostrimit përfshiu ndarjen e numrit të anketimeve të kryera në secilën prej komunave/lokaliteteve të përzgjedhura. Meqenëse anketa kishte për qëllim të pasqyrojë perceptimet e popullatës që jeton në komunat shumetnike në përgjithësi, dhe jo të pasqyrojë perceptimet e popullatës së komunave të përzgjedhura në veçanti, në secilin nga lokalitetet e lartpërmendura numri i anketave të kryera u nda në mënyrë proporcionale. Shtresimi i mëtejshëm i mostrës u bazua në regjistrimin e fundit të popullsisë në Kosovë. Në këtë drejtim, duke pasur parasysh se 51 për qind e popullsisë së përgjithshme të Kosovës janë meshkuj dhe 49 për qind janë femra, kjo është reflektuar edhe në mostrën tonë. Tutje, meqenëse 61 për qind e popullatës së përgjithshme të Kosovës banon në zonat rurale për dallim nga 39 për qind që banojnë në zonat urbane, rreth 60 për qind e anketave janë kryer në zonat rurale, ndërsa 40 për qind janë kryer në zonat urbane.

SI E PERCEPTOJNË QYTETARËT GJENDJEN E MARRËDHËNIEVE NDËRETNIKE NË KOSOVË?

Pajtimi synon të adresojë shkaqet rrënjësore dhe pasojat e konfliktit përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse. Në këtë drejtim, një sërë procesesh, secili prej të cilëve mund të funksionojë në nivel individual, komuniteti ose politik, mund të përfshihet në nxitjen e pajtimit, duke përfshirë zhvillimin e komunitetit, rritjen ekonomike, rindërtimin social, etj.¹ Në këtë drejtim, gjetjet e anketës, sipas interpretimit në këtë raport, mbështesin rëndësinë e ndërhyrjes sociale dhe ekonomike si një mekanizëm për nxitjen e harmonisë dhe pajtimit ndëretnik. Për shumicën e të anketuarve, konfliktet potenciale ndëretnike dhe çështjet politike nuk konsiderohen si çështje kryesore në komunitetet e tyre përkatëse, por si çështje që lidhen me mirëqenien qytetare. Në këtë aspekt, për 49 për qind të të anketuarve, shqetësimi kryesor konsiderohet papunësia dhe mungesa e vendeve të punës, pasuar nga korrupsioni në institucionet publike (12%), shërbimet e dobëta shëndetësore (11%) dhe cilësia e arsimit (9%).

TABELA 1 PERCEPTIMET NË LIDHJE ME SHQETËSIMET KRYESORE TË KOMUNITETEVE (N=1226)




Mirëpo, përkundër faktit se gjetjet e anketës tregojnë se serbët e Kosovës² dhe shqiptarët e Kosovës³ përgjithësisht kanë shqetësime të ngjashme, marrëdhëniet ndëretnike janë renditur si një nga tre shqetësimet më të theksuara në komunitet nga serbët e Kosovës, duke përbërë 13 për qind të totalit, krahas papunësisë dhe mungesës së vendeve të punës (46%) dhe korrupsionit në institucionet publike (12%).

1 Hamber, B. and Kelly, G., 2004. Reconciliation: A working definition. Democratic Dialogue.

2 Në tekstin e mëtejshëm: serb-K


3 Në tekstin e mëtejshëm: shqiptar-K

TABELA 2 PERCEPTIMET NË LIDHJE ME SHQETËSIMET KRYESORE TË KOMUNITETEVE SIPAS PÛRKATËSISË ETNIKE




30 për qind e të anketuarve gjithashtu përmendën papunësinë si kërcënimin kryesor për paqen dhe sigurinë e komuniteteve në Kosovë. Mirëpo, kur kërcënimet për komunitetin shtjellohen në margjinat e paqes dhe sigurisë, përveç papunësisë, 15 për qind e të anketuarve e konsiderojnë mungesën e pajtimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si kërcënim kyç për paqen dhe sigurinë, pasuar nga korrupsioni (14%), dhuna politike dhe ekstremizmi politik (13%) dhe marrëdhëniet ndëretnike (10%).

TABELA 3 PERCEPTIMET NË LIDHJE ME KËRCËNIMET KRYESORE PÛR PAQEN DHE SIGURINË E KOMUNITETEVE (N=1226)



Kur rezultatet shqyrtohen në mënyrë të pavarur për komunitetin shqiptar dhe serb, po ashtu vërehen perceptime të ngjashme. Ndonëse mungesa e pajtimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë konsiderohet si një nga kërcënimet kryesore nga 21 për qind e të anketuarve shqiptarë-K, kjo çështje nuk radhitet ndër tri shqetësimet kryesore për komunitetin serb-K. Përveç papunësisë, e cila shihet nga 30 për qind e serbëve-K si kërcënimi më i madh për paqen dhe sigurinë, marrëdhëniet ndëretnike konsiderohen si kërcënimi i dytë më i madh me 19 për qind të të anketuarve serbë-K që deklarojnë një gjë të tillë. Kjo tregon se ky komunitet është më i ndikuar nga kjo çështje, në krahasim me katër për qind të shqiptarëve-K që e konsiderojnë atë si kërcënim.

TABELA 4 PERCEPTIMET NË LIDHJE ME KËRCËNIMET KRYESORE PËR PAQEN DHE SIGURINË E KOMUNITETEVE SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE




Duket se këto dallime të vogla ndërmjet vlerësimeve të dy komuniteteve për kërcënimet ndaj paqes dhe sigurisë pasqyrojnë ndjesinë e perceptuar të sigurisë që të dy komunitetet kanë në Kosovë. Në këtë drejtim, shumica dërrmuese e komunitetit shqiptar-K, përkatësisht 84 për qind e tyre, thanë se ndiheshin të sigurt si pjesëtarë të grupit të tyre etnik në Kosovë, krahasuar me 44 për qind të komunitetit serb-K që kishin opinion të tillë. Për më tepër, një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve (17%) nga komuniteti serb-K thanë se nuk kishin mendim për këtë çështje, gjë që mund të jetë tregues i ngurrimit për të diskutuar çështjet e sigurisë për shkak të kontekstit më të cënueshëm në mesin e këtij komuniteti.

TABELA 5 PERCEPTIMET NË LIDHJE ME NDJENJËN E SIGURISË NË SHOQËRINË KOSOVARE SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE




Dallimet në qëndrimet e dy komuniteteve janë të dukshme edhe në opinionet e tyre nëse pakicat janë të diskriminuara në Kosovë. Për 56 për qind e të anketuarve shqiptarë-K dhe 76 për qind e të anketuarve serbë-K ka, ose ka deri diku, diskriminim ndaj grupeve pakicë, ndërsa 42% e shqiptarëve-K dhe 8% e serbëve-K besojnë se diskriminimi i tillë nuk është i pranishëm.

TABELA 6 PERCEPTIMET NËSE KA DISKRIMINIM NDAJ GRUPEVE PAKICË NË KOSOVË. TË PËRGJITHSHME DHE SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE




Në një kontekst të ngjashëm, 50 për qind e të anketuarve shqiptarë-K besojnë se dhuna ndaj komuniteteve pakicë në Kosovë është ndëshkuar në mënyrë adekuate, krahasuar me 24 për qind të të anketuarve serbë-K që ndajnë një perceptim të tillë. Për 41 për qind të të anketuarve serbë-K dhe 36 për qind të të anketuarve shqiptarë-K dhuna ndaj komuniteteve pakicë nuk është ndëshkuar në mënyrë adekuate. Megjithatë, në këtë rast, të dy komunitetet ishin më pak të gatshme për t'u përgjigjur, me 36 për qind të të anketuarve serbë-K dhe 14 për qind të të anketuarve shqiptarë-K që thonë se nuk kanë ndonjë mendim.

TABELA 7 PERCEPTIMET NËSE DHUNA NDAJ GRUPEVE PAKICË NË KOSOVË ËSHTË NDËSHKUAR NË MËNYRË ADEKUATE. TË PËRGJITHSHME DHE SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE



Pavarësisht nga sfidat e përbashkëta të identifikuar nga të anketuarit e të dy komuniteteve, gjetjet e anketës tregojnë gjithashtu se banorët e Kosovës janë përgjithësisht pesimistë për mënyrën se si marrëdhëniet ndëretnike po ecin tani. Në këtë kontekst, 38 për qind e të anketuarve mendojnë marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë janë të mira, krahasuar me 35 për qind që mendojnë se janë të këqija ose jo të mira, dhe 19 për qind që mendojnë se janë deri diku të mira. Për më tepër, për 32 për qind të të anketuarve serbë-K gjendja aktuale e marrëdhënieve ndëretnike konsiderohet e mirë apo e shkëlqyer, ndërsa 50 për qind e të anketuarve shqiptarë-K e ndajnë këtë opinion. Tutje, 48 për qind e të anketuarve shqiptarë-K e konsiderojnë gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike si jo të mirë apo të keqe. Nga ana tjetër, 15 për qind e serbëve-K e ndajnë këtë mendim dhe 45 për qind e tyre e shohin gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike deri diku të mirë.

TABELA 8 VLERËSIMI I TË ANKETUARVE PËR GJENDJEN E PËRGJITHSHME TË MARRËDHËNIEVE NDËRETNIKE NË KOSOVË. TË PËRGJITHSHME DHE SIPAS PÛRKATËSISË ETNIKE



Mirëpo, përgjigjet më të favorshme nga të anketuarit vërehen kur trajtohet e njëjta çështje në nivel lokal. Në këtë rast, 61 për qind e të anketuarve thanë se gjendja e marrëdhënieve ndëretnike është e mirë ose e shkëlqyeshme në komunat e tyre përkatëse. Gjendja e marrëdhënieve ndëretnike në nivel lokal shihet më favorshëm edhe nga të dy komunitetet, me 46% të serbëve-K dhe 71% të shqiptarëve-K që besojnë se kjo çështje qëndron mirë apo shkëlqyeshëm në komunat e tyre.


TABELA 9 VLERËSIMI I TË ANKETUARVE PËR GJENDJEN E PËRGJITHSHME TË MARRËDHËNIEVE NDËRETNIKE NË KOMUNËN E TYRE. TË PËRGJITHSHME DHE SIPAS PÛRKATËSISË ETNIKE




Për më tepër, 41 për qind e të anketuarve besojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë përmirësuar në Kosovë gjatë viteve të fundit, ndërsa 79 për qind shprehin shpresë se do të përmirësohen edhe më tej në të ardhmen. Sidoqoftë, nivele më të larta të skepticizmit vërehen te të anketuarit serbë-K, 32 për qind e të cilëve konsiderojnë se marrëdhëniet ndëretnike nuk janë përmirësuar, për dallim nga 12 për qind e të anketuarve shqiptarë-K që ndajnë mendim të tillë. Megjithatë, të dy komunitetet shohin potencialin e përmirësimit me 88 për qind të të anketuarve shqiptarë-K dhe 65 për qind të të anketuarve serbë-K të cilët deklarojnë se shpresojnë për marrëdhënie më të mira ndëretnike në të ardhmen.

TABELA 10 PERCEPTIMET NË LIDHJE ME PËRMIRËSIMIN E MARRËDHËNIEVE NDËRETNIKE NË KOSOVË GJATË VITEVE TË FUNDIT. TË PËRGJITHSHME DHE SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE

TË GJITHË TË ANKETUARIT (N=1226)



SHQIPTARË-K (N=729)




SERBË-K (N=497)




TABELA 11 PERCEPTIMET NË LIDHJE ME POTENCIALIN PËR PËRMIRËSIM TË MËTEJTMË TË MARRËDHËNIEVE NDËRETNIKE NË KOSOVË NË TË ARDHMEN. TË PËRGJITHSHME DHE SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE

- Nuk e di/Nuk kam mendim
- Shpresoj për marrëdhënie më të mira ndëretnike në të ardhmen
- Nuk shpresoj për marrëdhënie më të mira ndëretnike në të ardhmen
- Nuk jam i sigurt se marrëdhëniet ndëretnike do të përmirësohen në të ardhmen


TË GJITHË TË ANKETUARIT (N=1226)



SHQIPTARË-K (N=729)



SERBË-K (N=497)



Ndonëse të anketuarit shprehin një shkallë skepticizmi për gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike, perceptimi i tyre për natyrën shumetnike të Kosovës tregon se ka vullnet dhe gatishmëri për avancimin e marrëdhënieve ndëretnike në nivel komuniteti. Në këtë aspekt, 86 për qind e të anketuarve shqiptarë-K dhe 73 për qind e të anketuarve serbë-K e konsiderojnë Kosovën si shoqëri shumetnike. Ngjashëm, 81 për qind e të anketuarve shqiptarë-K dhe 78 për qind e të anketuarve serbë-K e shohin komunën e tyre si të tillë. Përveç kësaj, 83 për qind e të anketuarve shqiptarë-K dhe 74 për qind e të anketuarve serbë-K besojnë se Kosova duhet të jetë shumetnike, duke treguar potencialin e komuniteteve lokale për të avancuar marrëdhëniet ndëretnike, pasi ata tregojnë mirëkuptim dhe përqafim të parimeve themelore të Kosovës.

TABELA 12 PERCEPTIMET NË LIDHJE ME SHUMETNITETIN, SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE



Edhe pse gjetjet e lartpërmendura demonstrojnë gatishmërinë e komunitetit për të forcuar marrëdhëniet ndëretnike, shumica e të anketuarve, ose 68 për qind e tyre, besojnë se faktorët politikë, veçanërisht sjellja dhe gjuha e liderëve politikë në Kosovë, kanë ndikim në marrëdhëniet ndëretnike. Një perceptim të tillë e ndajnë 74 për qind e të anketuarve shqiptarë-K dhe 59 për qind e të anketuarve serbë-K, ndërsa 1/4 e të anketuarve serbë-K deklaruan se nuk kanë asnjë mendim për këtë çështje, gjë që, si në rastin e aspekteve të sigurisë të shtjelluara më herët në këtë raport, është tregues i ngurrimit të shtuar të këtij komuniteti për të shprehur qëndrimet e tyre për çështje që lidhen me politikën. Për më tepër, kur të anketuarit janë pyetur nëse konsiderojnë se kanë liri në komunat e tyre për të folur hapur për çështje politike, 35 për qind e të anketuarve serbë-K deklaruan se nuk e

kanë lirinë për ta bërë këtë, ndërsa 33 për qind konsiderojnë se e kanë këtë liri vetëm në deri në njëfarë mase. Nga ana tjetër, 71 për qind e të anketuarve shqiptarë-K besojnë se kanë lirinë të flasin hapur për çështjet politike në komunat e tyre.

TABELA 13 PERCEPTIMET NËSE SJELLJA E LIDERËVE POLITIKË DHE GJUHA E TYRE KANË NDIKIM NË MARRËDHËNIET NDËRETNIKE. TË PËRGJITHSHME DHE SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE





TABELA 14 PERCEPTIMET NËSE NË KOMUNAT E TË ANKETUARVE KA LIRI PËR TË FOLUR HAPUR PËR ÇËSHTJET POLITIKE. TË PËRGJITHSHME DHE SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE




Kur të anketuarve ju kërkua të vlerësojnë gjuhën e përdorur nga liderët politikë kur bëhet fjalë për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndëretnik, shumica e tyre u përcaktuan për përgjigjet që e kategorizojnë gjuhën e përdorur si jounifikuese. Për 51 për qind të të anketuarve shqiptarë-K dhe 61 për qind të të anketuarve serbë-K, gjuha e përdorur nga liderët politikë për marrëdhëniet ndëretnike konsiderohet armiqësore, deri diku armiqësore ose shumë armiqësore. Në anën tjetër, 41 për qind e komunitetit shqiptar-K e shohin gjuhën e përdorur si miqësore ose shumë miqësore, për dallim nga 8 për qind e të anketuarve serbë-K.


TABELA 15 VLERËSIMI I TË ANKETUARVE PËR GJUHËN E PËRDORUR NGA LIDERËT POLITIKË NË KOSOVË KUR BËHET FJALË PËR MARRËDHËNIET DHE BASHKËPUNIMIN NDËRETNIK. TË PËRGJITHSHME DHE SIPAS PÛRKATËSISË ETNIKE

- Nuk e di/Nuk kam mendim
- Miqësore dhe unifikuese
- Shumë miqësore dhe unifikuese
- Armiqësore/Jo unifikuese
- Deri diku armiqësore/jo unifikuese
- Shumë armiqësore/jo unifikuese


**TË GJITHË TË ANKETUARIT
(N=1226)**



SHQIPTARË-K (N=729)



SERBË-K (N=497)




SI E PERCEPTOJNË QYTETARËT BASHKËPUNIMIN NDËRETNIK?

Bashkëpunimi politik ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe përfaqësuesve politikë të komunitetit serb në Kosovë vazhdon të ketë ndikim në bashkëpunimin ndëretnik në Kosovë.⁴ Në këtë drejtim, opinionet e komuniteteve lokale ndaj këtyre dy entiteteve ndikojnë deri diku në mënyrën se si këto komunitete e shohin njëri-tjetrin dhe shkallën e bashkëpunimit ndërmjet tyre. Nga ana tjetër, literatura njih identifikimin e interesave të përbashkëta si mekanizëm që mund të reduktojë anshmëritë brenda grupit dhe të nxisë bashkëpunimin ndëretnik.⁵ Duke filluar nga rezultatet e anketës, të cilat treguan se mbi 50 për qind e të dy komuniteteve, përkatësisht 70 për qind e të anketuarve shqiptarë-K dhe 61 për qind e të anketuarve serbë-K, deklaruan se bashkëpunimi ndëretnik është i rëndësishëm apo shumë i rëndësishëm për ta, vërehet se bashkëpunimi ndëretnik mund të theksohet si interes i përbashkët i komuniteteve të ndryshme etnike në Kosovë. Për më tepër, 83 për qind e të anketuarve shqiptarë-K dhe 68 për qind e të anketuarve serbë-K e perceptojnë bashkëpunimin ndëretnik si të rëndësishëm ose shumë të rëndësishëm për Kosovën.


TABELA 16 PERCEPTIMET NË LIDHJE ME RËNDËSINË E BASHKËPUNIMIT NDËRETNIK SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE

A është i rëndësishëm bashkëpunimi ndëretnik për ju?

SHQIPTARË-K (N=729)




SERBË-K (N=497)




A është i rëndësishëm bashkëpunimi ndëretnik për Kosovën

SHQIPTARË-K (N=729)



SERBË-K (N=497)



4 Orana, A. (2021) "A mund ta përdorë Kurti momentin për të filluar bashkëpunim të mirëfilltë ndëretnik?," Kosovo 2.0. Kosovo 2.0. Në dispozicion këtu: <https://kosovotwopointzero.com/a-mund-ta-perdore-kurti-momentin-per-te-filluar-bashkepunim-te-mirefillte-nderetnik/>

5 Butler, D. and Tavits, M. (2020) "Shared interests foster interethnic cooperation among politicians," Political Science Research and Methods, 9(3), ff. 627–640. Në dispozicion këtu: <https://doi.org/10.1017/psrm.2019.60>.


Të anketuarit nga të dy grupet gjithashtu e pranojnë rëndësinë e bashkëpunimit ndëretnik për sa i përket kontributit të tij në zhvillimin e Kosovës, si në sferën ekonomike apo integrimet evropiane. Për 98 për qind të të anketuarve shqiptarë-K dhe 89 për qind të të anketuarve serbë-K, marrëdhëniet më të mira ndëretnike ndihmojnë zhvillimin ekonomik të Kosovës. Nga ana tjetër, kur kjo çështje u analizua në margjinat e integritit evropian, 33 për qind e të anketuarve serbë-K deklaruan se nuk kanë mendim për këtë çështje, ndërsa 45 për qind e tyre janë të mendimit se bashkëpunimi më i mirë ndëretnik përmirëson procesin e integritit evropian të Kosovës. Mendimin e tillë e ndajnë 89 për qind e të anketuarve shqiptarë-K.

TABELA 17 PERCEPTIMET PËR KONTRIBUTIN E MARRËDHËNIEVE NDËRETNIKE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS DHE INTEGRIMIN EVROPIAN SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE

A mendoni se marrëdhëniet më të mira ndëretnike mund të ndihmojnë zhvillimin ekonomik të Kosovës?

SHQIPTARË-K (N=729)

Nuk e di/Nuk kam mendim 2%
 Jo 8%
 Po 91%



SERBË-K (N=497)

Nuk e di/Nuk kam mendim 11%
 Jo 10%
 Po 79%



A mendoni se marrëdhëniet më të mira ndëretnike do të përmirësojnë procesin e integritit evropian për Kosovën?

SHQIPTARË-K (N=729)

Nuk e di/Nuk kam mendim 3%
 Jo 8%
 Po 89%




SERBË-K (N=497)

Nuk e di/Nuk kam mendim 33%
 Jo 22%
 Po 45%



Mirëpo, vërehen dallime në opinione ndërmjet dy komuniteteve në vlerësimin e tyre për bashkëpunimin aktual ndëretnik në Kosovë. Përdërisa 44 për qind e të anketuarve shqiptarë-K e vlerësojnë bashkëpunimin ndëretnik në Kosovë si të mirë apo të shkëlqyeshëm, 17 për qind e të anketuarve serbë-K ndajnë një opinion të tillë. Nga ana tjetër, 32 për qind e të anketuarve serbë-K e vlerësojnë bashkëpunimin ndëretnik si të keq ose shumë të keq, për dallim nga tetë për qind e të anketuarve shqiptarë-K që kanë pikëpamje të tilla.


TABELA 18 VLERËSIMI I TË ANKETUARVE PËR GJENDJEN E BASHKËPUNIMIT NDËRETNIK NË KOSOVË. TË PËRGJITHSHME DHE SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE



Të dy komunitetet ndajnë pikëpamje të ngjashme kur bëhet fjalë për pengesat me të cilat përballen marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë. Për komunitetin shqiptar-K, mungesa e drejtësisë për krimet e kryera gjatë luftës në vitet e 90-ta (36%), refuzimi i Serbisë për të pranuar pavarësinë e Kosovës (26%) dhe mungesa e pajtimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (19%), janë pengesat më të rëndësishme për marrëdhënie më të mira ndëretnike. Nga ana tjetër, komuniteti serb-K i rendit paragjykimet ndaj njëri-tjetrit në komunitet (23%) dhe mungesën e pajtimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (21%) si pengesa kryesore. Për më tepër, 22 për qind e të anketuarve serbë-K nuk kanë dhënë mendim për këtë çështje, ndërsa 15 për qind e tyre shohin mungesën e drejtësisë për krimet e kryera gjatë luftës në vitet e 90-ta si pengesë të rëndësishme.


TABELA 19 PERCEPTIMET NË LIDHJE ME PENGESAT MË TË RËNDËSISHME PËR MARRËDHËNIE MË TË MIRA NDËRETNIKE NË KOSOVË. TË PËRGJITHSHME DHE SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE

- Nuk e di/Nuk kam mendim
- Mungesa e drejtësisë për krimet e kryera gjatë luftës në vitet e 90-ta
- Mungesa e pajtimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë
- Mungesa e besimit ndërmjet komuniteteve të ndryshme në Kosovë
- Refuzimi i Serbisë për të pranuar pavarësinë e Kosovës
- Paragjykimet ndaj njëri-tjetrit në komunitet
- Tjetër




Gatishmëria e qytetarëve për të mbështetur një parti politike nga një grup tjetër etnik dhe perceptimet e tyre për potencialin për të mësuar gjuhët e komuniteteve të tjera etnike, si shqipja dhe serbishtja, në shkolla, merren gjithashtu parasysh kur analizohen perceptimet e qytetarëve për bashkëpunimin ndëretnik. Për sa i përket mbështetjes politike, të anketuarit shqiptarë-K shprehen më qartë, ku 75% e tyre deklaruan se nuk do të votonin për një parti politike që nuk përfaqëson grupin e tyre etnik, për dallim nga 39% e të anketuarve serbë-K që ndajnë këtë pikëpamje. Mirëpo, 7 për qind e të anketuarve shqiptarë-K dhe 39 për qind e të anketuarve serbë-K thanë se mbase mund ta bënin këtë në të ardhmen, ndërsa 16 për qind e të anketuarve shqiptarë-K dhe 10 për qind e të anketuarve serbë-K mbeten të hapur për të votuar për një parti politike që nuk përfaqëson grupin e tyre etnik.

TABELA 20 GATISHMËRIA E TË ANKETUARVE PËR TË VOTUAR PËR NJË PARTI POLITIKE QË NUK PËRFAQËSON GRUPIN E TYRE ETNIK. TË PËRGJITHSHME DHE SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE



Për sa i përket përkrahjes së të anketuarve për mësimin e gjuhëve të grupeve tjera etnike, si shqipja dhe serbishtja, 38 për qind e të anketuarve shqiptarë-K dhe 41 për qind e të anketuarve serbë-K mendojnë se komunitetet lokale në Kosovë do të duhej të mësonin gjuhët e grupeve të tjera etnike në shkolla. Ndryshe nga kjo, 51 për qind e të anketuarve shqiptarë-K dhe 20 për qind e të anketuarve serbë-K mendojnë se kjo nuk do të duhej të ndodhte, por 23 për qind e të anketuarve serbë-K dhe 10 për qind e të anketuarve shqiptarë-K e konsiderojnë se një gjë e tillë mund të jetë e mundshme për të ardhmen.

TABELA 21 PERCEPTIMET NËSE GJUHËT E KOMUNITETEVE TJERA, SI SHQIPJA DHE SERBISHTJA, DO TË DUHEJ TË MËSOHEN NË SHKOLLA. TË PËRGJITHSHME DHE SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE




A JANË QYTETARËT TË KËNAQUR ME PUNËN E INSTITUCIONEVE TË NIVELIT KOMUNAL DHE QENDROR NË AVANCIMIN E MARRËDHËNIEVE NDËRETNIKE?

Përfaqësimi i bashkësive etnike në jetën politike është aspekt thelbësor i marrëdhënieve ndëretnike sepse ndikon në mënyrën se si qytetarët i shohin institucionet dhe kapacitetin e tyre për të përfaqësuar interesat e tyre. Për më tepër, ai gjithashtu ka ndikim në mënyrën se si komunitetet lokale i shohin dhe ndërveprojnë me qytetarët nga grupet e tjera etnike, duke mundësuar kështu kohezion më të mirë social në një shoqëri shumetnike.⁶ Në këtë drejtim, kjo pjesë e anketës u fokusua në përshtypjet e qytetarëve për përfaqësimin e tyre në shoqërinë kosovare dhe në nivel lokal, si dhe perceptimet e tyre për rolin që luajnë institucionet në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike.


Për dallim nga 69 për qind e të anketuarve shqiptarë-K, 15 për qind e të anketuarve serbë-K deklaruan se ndihen të përfaqësuar në shoqërinë kosovare, ndërsa 26 për qind thanë se ndihen të përfaqësuar deri diku. Nga ana tjetër, 31 për qind e të anketuarve serbë-K nuk ndihen të përfaqësuar në shoqërinë kosovare, përderisa 11 për qind e të anketuarve shqiptarë-K ndajnë një pikëpamje të tillë. Ndjesia e përfaqësimit rritet kur kjo temë shikohet nga këndvështrimi lokal. Në këtë aspekt, 83 për qind e të anketuarve shqiptarë-K pajtohen se ndihen plotësisht ose deri diku të përfaqësuar në komunën e tyre, ndërsa 51 për qind e të anketuarve serbë-K thonë të njëjtën gjë.

TABELA 22 PERCEPTIMET NËSE QYTETARËT E KOSOVËS NDIHEN TË PËRFAQËSUAR NË SHOQËRINË KOSOVARE. TË PËRGJITHSHME DHE SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE




⁶ O'Brochta, W. (2021) "Citizen responses to ethnic representation," Political Studies, f. 003232172110198. Në dispozicion këtu: <https://doi.org/10.1177/00323217211019834>.

TABELA 23 PERCEPTIMET NËSE QYTETARËT E KOSOVËS NDIHEN TË PËRFAQËSUAR NË KOMUNAT E TYRE PËRKATËSE. TË PËRGJITHSHME DHE SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE



Ndjenja e përfaqësimit në shoqërinë e Kosovës reflekton edhe perceptimet e qytetarëve për punën e institucioneve në avancimin e marrëdhënieve ndëretnike. Në këtë aspekt, për deri sa të anketuarit shqiptarë-K besojnë se si Qeveria e Kosovës ashtu edhe komunat e tyre përkatëse janë duke bërë punë të mjaftueshme për avancimin e marrëdhënieve ndëretnike, të anketuarit nga komuniteti serb-K mbeten skeptik ndaj punës së Qeverisë, ndërsa shprehin vlerësime më të mira për punën e komunave në këtë çështje. Për 56 për qind të të anketuarve shqiptarë-K, Qeveria është duke punuar mjaftueshëm për avancimin e marrëdhënieve ndëretnike, ndërsa 54 për qind ndajnë mendim të tillë për komunat e tyre përkatëse. Nga ana tjetër, ndërsa 21 për qind e të anketuarve serbë-K e vlerësojnë pozitive punën e komunave të tyre për marrëdhëniet ndëretnike, nëntë për qind e tyre ndajnë qëndrim të tillë për Qeverinë e Kosovës.


TABELA 24 PERCEPTIMET NË LIDHJE ME PUNËN E QEVERISË SË KOSOVËS DHE KOMUNAVE NË AVANCIMIN E MARRËDHËNIEVE NDËRETNIKE SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE



A besoni se komuna juaj po punon mjaftueshëm për avancimin e marrëdhënieve ndëretnike?

SHQIPTARË-K (N=729)

Nuk e di/Nuk kam mendim 5%
 Jo 14%
 Deri diku 26%
 Po 54%



SERBË-K (N=497)


Nuk e di/Nuk kam mendim 12%
 Jo 26%
 Deri diku 40%
 Po 21%




Edhe pse në përgjithësi ka perceptim më të favorshëm të përpjekjeve lokale për avancimin e marrëdhënieve ndëretnike, qytetarët e Kosovës tregojnë mungesë familjariteti me organet komunale si Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi që ekzistojnë në të gjitha komunat e Kosovës dhe janë përgjegjës për diskutimin e çështjeve të sigurisë së komuniteteve lokale. Në këtë drejtim, 68 për qind e të anketuarve, respektivisht 79 për qind e shqiptarëve-K dhe 52 për qind e serbëve-K, deklaruan se nuk janë të njohur me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi në komunën e tyre përkatëse.

TABELA 25 PERCEPTIMET NËSE QYTETARËT JANË TË NJOHUR ME KËSHILLIN KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI NË KOMUNAT E TYRE PËRKATËSE. TË PËRGJITHSHME DHE SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE


TË GJITHË TË ANKETUARIT (N=1226)



SHQIPTARË-K (N=729)



SERBË-K (N=497)



Për më tepër, të anketuarit duket se nuk janë në dijeni për ligjet që janë në fuqi për të mbrojtur qytetarët nga diskriminimi dhe për të avancuar të drejtat e komuniteteve. Në këtë aspekt, kur u pyetën nëse janë në dijeni për Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 48 për qind e shqiptarëve-K dhe 53 për qind e serbëve-K u përgjigjën se nuk janë në dijeni. Përveç kësaj, 50 për qind e të anketuarve shqiptarë-K dhe 45 për qind e të anketuarve serbë-K thanë se nuk janë në dijeni se ka ligje që mbrojnë të drejtat e tyre.

A janë qytetarët të kënaqur me punën e institucioneve të nivelit komunal dhe qendror në avancimin e marrëdhënieve ndëretnike?

TABELA 26 DIJENIA E TË ANKETUARVE PËR EKZISTIMIN E LIGJEVE QË MBROJNË TË DREJTAT E TYRE

A jeni në dijeni për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi?

SHQIPTARË-K (N=729)

Nuk e di/Nuk kam mendim 2%
Jo 48%
Po 50%



SERBË-K (N=497)

Nuk e di/Nuk kam mendim 16%
Jo 53%
Po 32%



A jeni në dijeni se ka ligje që mbrojnë të drejtat tuaja?

SHQIPTARË-K (N=729)

Nuk e di/Nuk kam mendim 2%
Jo 50%
Po 48%



SERBË-K (N=497)


Nuk e di/Nuk kam mendim 12%
Jo 45%
Po 42%



SA E PRANOJNË NJËRI-TJETRIN QYTETARËT E KOSOVËS?

Gjasa e intolerancës zvogëlohet duke i ekspozuar grupet e ndryshme etnike me njëri-tjetrin dhe duke nxitur më shumë ndërveprime ndërmjet anëtarëve të komuniteteve të ndryshme.⁷ Rritja e ndërveprimit ndërmjet grupeve të ndryshme etnike bën të mundur edhe formimin e perceptimeve të bazuara në përvojën dhe kontaktin e drejtpërdrejtë, duke ulur kështu gjasat e paragjyqimeve sociale. Në këtë drejtim, anketa e projektit FIECR ka shqyrtuar opinionet e qytetarëve të Kosovës për tolerancën e shoqërisë kosovare. Shoqëria kosovare perceptohet si tolerante ndaj etnive të tjera nga 82 për qind e të anketuarve shqiptarë-K dhe 31 për qind e të anketuarve serbë-K. Nga ana tjetër, 38 për qind e të anketuarve nga komuniteti serb-K mendojnë se shoqëria kosovare është intolerante ndaj etnive të tjera, ndërsa 31 për qind e tyre refuzuan të shprehin mendimin e tyre për këtë temë.

TABELA 27 PERCEPTIMET NËSE SHOQËRIA KOSOVARE ËSHTË TOLERANTE NDAJ ETNIVE TË TJERA. TË PËRGJITHSHME DHE SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE




Perceptimet përkitazi me tolerancën u analizuan më tej përmes vlerësimit të gatishmërisë së qytetarëve për të pranuar komunitetet e ndryshme në një sërë shkallësh, nga marrëdhëniet më të gjera deri tek ato më personale. Edhe të anketuarit shqiptarë-K edhe të anketuarit serbë-K në këtë rast e përshkruajnë veten si më të gatshëm të pranojnë komunitetet e tjera që banojnë në Kosovë si dhe njëri-tjetrin në kontekste të komunitetit më të gjerë në krahasim me nivelin personal. Në lidhje me këtë, më shumë se 50 për qind e të anketuarve shqiptarë-K dhe serbë-K thanë se do të pranonin njëri-tjetrin si dhe komunitetet rom, ashkali, egjiptian, turk dhe boshnjak që të jetonin në lagjet e tyre, të punonin pranë njëri-tjetrit, ose të ishin shokë. Mbi 50 për qind e të anketuarve shqiptarë-K thanë se do t'i pranonin të gjitha komunitetet e lartpërmendura si zyrtarë publikë në vendin e tyre, krahasuar me më pak se 40 për qind të të anketuarve serbë-K të cilët ishin të hapur për pranimin e personave nga këto komunitete si zyrtarë publikë në vendin e tyre. Ekziston hendek më i madh në mes të komuniteteve për sa i përket nivelit personal, siç dëshmohet nga fakti se shumica e të anketuarve nga të dy grupet etnike nuk do të kishin miratuar që dikush

⁷ Laurence, J. (2013) "Reconciling the contact and threat hypotheses: Does ethnic diversity strengthen or weaken community inter-ethnic relations?," *Ethnic and Racial Studies*, 37(8), ff. 1328–1349. Në dispozicion këtu: <https://doi.org/10.1080/01419870.2013.788727>

nga këto komunitete të martohet me ndonjë anëtar të familjes së tyre. Në përgjithësi, të anketuarit shqiptarë-K janë më të hapur ndaj komunitetit turk, ndërsa të anketuarit serbë-K tregojnë më shumë afërsi me komunitetin boshnjak në Kosovë.


TABELA 28 GATISHMËRIA E TË ANKETUARVE SHQIPTARË-K PËR TË PRANUAR KOMUNITETET E NDRYSHME NË NJË SËRË SHKALLËSH, NGA MARRËDHËNIET MË TË GJERA DERI TEK ATO MË PERSONALE ⁸

A DO TË PRANONIT KOMUNITETET E MËPOSHTME NË SITUATAT VIJUESE:




⁸ Opsioni "Nuk e di/Nuk kam mendim" nuk është përfshirë në këtë tabelë, kështu që shumica e rezultateve nuk do të dalë 100%.

BOSHNJAK



EGJIPTIAN



TURK





TABELA 29 GATISHMËRIA E TË ANKETUARVE SERBË-K PËR TË PRANUAR KOMUNITETET E NDRYSHME NË NJË SËRË SHKALLËSH, NGA MARRËDHËNIET MË TË GJERA DERI TEK ATO MË PERSONALE ⁹


A DO TË PRANONIT KOMUNITETET E MËPOSHTME NË SITUATAT VIJUESE:

SHQIPTAR




⁹ Opsioni "Nuk e di/Nuk kam mendim" nuk është përfshirë në këtë tabelë, kështu që shuma e rezultateve nuk do të dalë 100%.


ROM




ASHKALI




BOSHNJAK



EGJIPTIAN



TURK



KONKLuzionet Kryesore

Vullneti për të përmirësuar marrëdhëniet ndëretnike mund të shihet në perceptimet e qytetarëve të Kosovës për shoqërinë e tyre si shumetnike dhe pozicionimin e tyre se Kosova do të duhej të mbetet e tillë. Komuniteti serb-K, megjithatë, shfaqë ndjenjë më të fortë se nuk ndihet i përfaqësuar në shoqërinë kosovare, ndërkohë që gjithashtu në përgjithësi vlerëson dobët punën e institucioneve të Kosovës në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike. Kjo sugjeron që nevojiten përpjekje më të mëdha nga ana e institucioneve të Kosovës për të ju afruar komuniteteve joshumicë për të kuptuar më mirë nevojat e tyre. Fakti që përpjekjet e komunave për të përmirësuar marrëdhëniet ndëretnike shihen më pozitivisht sesa ato të institucioneve qendrore, tregon rolin vendimtar që luan kontakti me institucionet, përfaqësimi adekuat dhe qasja në to për të siguruar që të gjitha bashkësitë etnike përfaqësohen në mënyrë të drejtë.

Gjetjet tregojnë se komuniteti shumicë shqiptar në Kosovë ndihet më i sigurt se komuniteti serb, ndërsa ngurrimi më i theksuar i komunitetit serb për të ju përgjigjur pyetjeve rreth klimës politike dhe çështjeve të sigurisë sugjeron gjithashtu perceptime më skeptike për sigurinë dhe mjedisin politik brenda këtij komuniteti. Kjo dëshmohet edhe nga fakti se, ndryshe nga komuniteti shqiptar, i cili i pranon gjerësisht këto probleme potenciale por nuk i vendosë në të njëjtin nivel me komunitetin serb, perceptimet e diskriminimit dhe dështimit për të trajtuar në mënyrë adekuate dhunën e mundshme kundër pakicave etnike janë më të larta në mesin e komunitetit serb.

Pjekuria politike është vendimtare në adresimin e çështjeve ndëretnike, siç dëshmohet nga perceptimet e qytetarëve për efektet e dëmshme të retorikës së elitës politike në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike. Përveç kësaj, pasi për shumicën e të anketuarve bashkëpunimi ndëretnik shihet si i rëndësishëm, përpjekjet politike për avancimin e këtij synimi duhet të jenë të bazuara në komunitet dhe si të tilla duhet të reflektojnë nevojat dhe kërkesat e qytetarëve. Tutje, duke pasur parasysh se krimet e luftës të viteve të 90-ta dhe dështimi për të arritur pajtimin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë perceptohen si barriera për përmirësimin e bashkëpunimit ndëretnik, zgjidhjet politike duhet të jenë në përputhje me opinionin publik për të pasur ndikim edhe në pajtimin ndërshoqëror.

Duke pasur parasysh se si komuniteti shqiptar ashtu edhe ai serb i shohin çështjet si papunësia, korrupsioni, sistemi i dobët arsimor, e të tjera, si kërcënime madhore për komunitetin, adresimi i çështjeve të mirëqenies sociale mund të shihet si një nga emëruesit e përbashkët të qytetarëve të Kosovës. Në këtë aspekt, një sistem i fokusuar në çështjet praktike për të gjitha komunitetet në Kosovë paraqet mekanizëm të rëndësishëm për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe do të mundësonte një proces më gjithëpërfshirës të integritetit të komuniteteve joshumicë.

RRETH PROJEKTIT FIECR - NXITJA E BASHKËPUNIMIT DHE PAJTIMIT NDËRETNIK

Projekti FIECR (akronim i emërimit në gjuhën angleze, Fostering Inter-Ethnic Cooperation and Reconciliation) është projekt 18-mujor i financuar nga Fondi i Paktit të Stabilitetit të Ministrisë së Jashtme Federale Gjermane, dhe implementohet nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) në partneritet me Iniciativën e Re Sociale (NSI, akronim i emërimit në gjuhën angleze New Social Initiative). Projekti FIECR - Nxitja e bashkëpunimit dhe pajtimit ndëretnik punon për të rritur bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve në mënyrë që të përmirësojë mundësitë e zhvillimit dhe të aktivizojë qytetarinë aktive në proceset e vendimmarrjes komunale për të avancuar interesin publik në komunitetet e ndara në Kosovë, me fokus në komunitetin shqiptar dhe komunitetin serb. Objektivi i përgjithshëm i projektit është nxitja e bashkëpunimit ndëretnik në Kosovë duke ofruar hapësirë ndërveprimi për ndërtimin e besimit të ndërsjellë, duke krijuar mundësi që qytetarët së bashku të identifikojnë/adresojnë sfidat e përbashkëta dhe të bashkëpunojnë për të gjetur zgjidhje brenda komunitetit.

Projekti FIECR ka tre komponentë:

Komponenti I: Hulumtimi dhe analiza: Qëllimi i komponentit të parë të hulumtimit dhe analizës është të ofrojë kuptim më të plotë se si qytetarët dhe udhëheqësit e komuniteteve i perceptojnë marrëdhëniet ndëretnike në komunitetin e tyre dhe cilat pengesa parandalojnë bashkëpunimin më të mirë. Hulumtimi dhe analiza do të shoqërohen dhe mbështeten nga konsulentë akademikë të jashtëm, në formën e rishikimeve të aktiviteteve hulumtuese dhe punëtorive për metodat sasiore dhe cilësore të hulumtimit dhe etikën e hulumtimit. Si pjesë e komponentit të parë, në lokalitete me diversitet etnik në Kosovë do të kryhet një anketë e opinionit publik rreth perceptimit të komunitetit për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndëretnik. Gjithashtu, do të zhvillohen dhe do të promovohen video motivuese dhe ndërgjegjësuese me udhëheqës të komunitetit dhe qytetarë.

Komponenti II: Zhvillimi i ndërtimit të kapaciteteve dhe trajnimet: Qëllimi i komponentit të dytë është të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë për zhvillimin e aftësive dhe njohurive në radhët e organizatave joqeveritare, institucioneve publike, udhëheqësve të komunitetit, sektorit privat dhe komunitetit të biznesit për t'u angazhuar në mënyrë më aktive në proceset kombëtare të vendimmarrjes. Kjo do të arrihet përmes trajnimeve, mentorimeve dhe udhëzimeve në punë (në gjuhën angleze job-coaching), që do të përmirësojnë aftësitë e buta të qytetarëve për t'i ndihmuar të çojnë përpara iniciativat ekonomike dhe bizneset fillestare (në gjuhën angleze start-up), të cilat do t'i mbështesin në zhvillimin e ideve të projekteve.

Komponenti III: Avokimi dhe angazhimi: Qëllimi i komponentit të tretë është të mbështesë drejtpërdrejt bashkëpunimin ndëretnik përmes angazhimit në nivel të komunitetit (në gjuhën angleze grassroots). Fokusi parësor i këtij komponenti do të jetë rritja e aktivizimit qytetar të komunitetit të synuar dhe komunave dhe përfshirja në aktivizëm për interesat e përbashkëta të komunitetit si: mbrojtja e të drejtave themelore të komunitetit, mbrojtja e mjedisit, trajtimi i dhunës në familje, etj. Rezultati kyç i këtij komponenti do të jetë krijimi i Forumit të Komunitetit

për Bashkëpunim në Çështje me Interes Publik i cili do të jetë trup joformal por do të shërbejë si mekanizëm koordinues. FIECR do të mbështesë deri në 10 iniciativa komunitare të cilat janë të dizajnuara për të adresuar çështje apo interesa të komunitetit, me grante të vogla deri në 500 euro. Përveç kësaj, FIECR do të mbështesë gjashtë iniciativa biznesi start-up, me deri në 1,500 euro për secilën iniciativë.

Katalogimi në botim **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës - "Pjetër Bogdani"

316(496.51)(047)


Balaj, Shpat

Çfarë janë perceptimet e qytetarëve të Kosovës për marrëdhëniet ndëretnike? : rezultatet e anketës lidhur me nxitjen e marrëdhënieve dhe pajtimit ndëretnik / Shpat Balaj, Gramos Sejdiu. - Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2023. - 25 f. ; 24 cm.

Marrëdhëniet etnike -- Raporte, intervista -- Kosovë

ISBN 978-9951-799-83-6

Aleph [000105555]



ISBN 978-9951-799-83-6



9 789951 799836